



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor
Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 3/229
Datë: 27/10/2016

Senati i Universitetit të Prishtinës, me kërkesë nr. ref. 1137 të dt. 04.10.2016 të Rektorit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e XII-të, të mbajtur më datën 14.10.2016, mori

V E N D I M

mbi ndryshim plotësim të nenit 6 paragrafi 1, 4 dhe 5 të Marrëveshjes së Mirëkuptimit nr. prot. 1614 dt. 14.5.2015

Neni 6 paragrafi 1, 4 dhe 5 i Marrëveshjes së Mirëkuptimit nr. prot. nr. 1614 dt. 14.5.2015, ndryshohen si vijon:

1. Studentët e njësive akademike të UP-së (FGJT dhe FSHA në Mitrovicë), të regjistruar para vitit akademik 2013/14 nga data 31.12.2016 do të konsiderohen studentë të UMIB-it.
2. Të gjithë studentëve të njësive akademike të UP-së (FGJT dhe FSHA në Mitrovicë) të cilët diplomojnë deri më datë 30.12.2016 do të pajisen me diploma, certifikata, vërtetime dhe dokumentacion tjetër përcjellës nga UP. Diplomat do të nënshkruhen nga dekani aktual i njësisë akademik përkatëse të UMIB-it dhe nga rektori i UP-së.
3. Studentët të cilët i takojnë kategorisë si në pikën 4, e të cilët nuk arrijnë të diplomojnë deri më 30.12.2016 do të transferohen në programe të njëjta në kuadër të fakulteteve përkatëse të UMIB-it.
4. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Rektorit të UMIB;
3. Sekretarëve të njësive akademike;
4. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
5. Për publikim në ueb-faqe.

REKTORI

Prof. Dr. Marjan Dema

